

Kurrikula, si bazë kryesore e mësimdhënies dhe e të nxënit

Dr. Leticja Gusho

Rezultatet e të nxënimit

Pjesëmarrësit do të jenë të aftë të:

- ▶ përcaktojnë se çfarë është kurrikula dhe cilët janë aktorët kryesorë të saj;
- ▶ analizojnë se përse teoritë kryesore të të nxënimit janë në themel të kurrikulës dhe të procesit të mësimdhënies;
- ▶ të gjykojnë midis efektshmërisë së lidhjes së teorive të të nxënimit dhe modelit të kurrikulës që zbatohet në sistemin arsimor shqiptar.

Ç'është Kurrikula?

- ▶ Jepni një përkufizim të shkurtër për kurrikulën.

Mësuesi dhe kurrikula

- ▶ Roli i drejtuesit të institucionit arsimor
 - ▶ Roli i mësuesit
 - ▶ Roli i aktorëve të tjerë

Jepet situata e mëposhtëme:

- ▶ “Një mësuese e klasës së nëntë të lëndës “Gjuhë Shqipe”, përdor në klasë disa elementë të të mësuarit bihejviorist . Mësuesja në përgjithësi i jep objektivat përpara se të fillojë orën e mësimit. Ajo përdor përforcimin si një element themelor për realizimin e procesit të të nxënës. Kështu, pas çdo ore mësimi ajo lë 5-7 minuta për të përforcuar njohuritë e reja të cilat janë dhënë gjatë asaj ore mësimi. Ajo përdor shpesh, vlerësimin me notë negative kur nxënësit i vijnë qoftë edhe njëherë pa detyra shtëpie. Gjatë orës së mësimit, nëse e sheh që nxënësit nuk janë të gatshëm për të vazhduar më tej me njohuritë e marra, apo nuk i kanë konsoliduar ato sa duhet, ajo vazhdon me trajtimin e materialit të ri. Gjithashtu, ajo në klasë përdor shumë shpesh përsëritjet periodike, të cilat i konsideron si vendimtare për mbajtjen mend të informacionit”
- ▶ Sipas mendimit tuaj, çfarë ka bërë si duhet dhe çfarë jo, kjo mësuese? (Identifikoni vetëm nje tregues pozitiv dhe nje tregues negativ)

Të mësuarit bihejviorist

- ▶ Përforcimi është themelor për realizimin e të mësuarit.
- ▶ Praktika me informim, përmirëson të mësuarit dhe kujtesën.
- ▶ Përsëritjet periodike janë vendimtare për mbajtjen mend të informacionit.
- ▶ Të mësuarit nëpërmjet shpërblimit është më i pëlqyeshëm se të mësuarit nëpërmjet ndëshkimit.
- ▶ Të mësuarit kalon nga sjellja e thjeshtë në sjelljen e ndërlikuar dhe nga sjellja e pjesshme në sjelljen e plotë.
- ▶ Të mësuarit duhet të realizohet pjesë-pjesë dhe hap pas hapi.
- ▶ Të mësuarit është hierarkik, i mbështetur në gadishmërinë e vazhduar.
- ▶ Ecuria e dëshirueshme dhe rezultatet e të mësuarit duhet të shpallen paraprakisht (dhe me objektiva).
- ▶ Të mësuarit është i vëzhgueshëm dhe/ose i matshëm.

Përmbledhje

- ▶ Reagime nga pjesëmarrësit
- ▶ Përmbledhje e koncepteve kryesore
 - ▶ Informacion mbi takimin vijues

Faleminderit p r V emendjen!